

Angazhohu Monitoro Veopro



SUPLEMENT NGA GRUPI MONITORUES I KËSHILLIT BASHKIAK, POGRADEC, KORRIK 2012

*Sindromës së veçimit,
mos iu nënshetro!*

Së bashku me Këshillin,

Angazhohu - Monitoro - Veopro!

Monitorimi
i Këshillit
Bashkiak,
Pogradec
Dosja Nr. 5,
Korrik 2012



PUSHTET VENDOR:

**KËSHILLI BASHKIAK "DELEGON" FUNKSIONE NË DOBI
TË QYTETARIT** faqe 6

**IMPRESIONE NGA PANAIRI
"BËJ TË DËGJOHET ZËRI YT!"** faqe 6

"NJË KARRIGE, JU LUTEM!" faqe 7

"DEKLARATA PËR QEVERISJE TË HAPUR"
..... faqe 8-9

**ZGJIDHNI QUITZ NË FAQEN 12 DHE MERRNI NJË DHURATË NGA
GRUPI MONITORUES**

EDITORIAL

Sot, mjafton të përmendim që në një prej mbledhjeve të monitoruara nga ekipi ynë 'ANGAZHOHU – MONITORO – VEPRO', në shtim e sipër të aktivistëve vullnetarë, unë dhe Ledioni përsëritëm lutjen e para një dekade: -Një karrige, ju lutem! Edhe pse mungesa e qytetarëve jashtë grupit tonë ndihet



në mënyrë të konsiderueshme, përsëri me ftesë të hapur për monitorim dhe pjesëmarrje, ju pohojmë se salla e re e Këshillit Bashkiak, premtion vende për këdo të interesuar, ndryshe nga e kaluara. Pikërisht kjo më fal kënaqësi dhe më bën të ndihem i shumëpërfaqësuar, jo vetëm nga këshilltarët, kryesia e bashkisë, por tashmë, edhe nga qytetarët e interesuar për procesin thelbësor të vendimmarrjes. Këta vektorë në rritje nxjerrin rezultanten e dëshiruar, që të jemi pranë vendimmarrjes lokale me dëshirën dhe domosdoshmërinë për të njohur, zhvilluar dhe ruajtur me fanatizëm vlerat e qytetit tonë piktoresk, natyrisht në shinat e duhura ligjore.

Lexoni në faqen 7 →



Duke ideuar suplementin...

Kryeredaktor:
Dorian LEKA
Redaktor letrar
Ilir SHYTA

KËSHILLI BASHKIAK ‘DELEGON’ FUNKSIONE NË DOBI TË QYTETARIT

Shkruar nga: Dhimitër Gegprifti

Në mbledhjen e tij të radhës Këshilli Bashkiak i Pogradecit, i mbledhur më 11.07.2012, miratoi “Projektvendimin për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 1-30 qershor 2012”.

Me arsyetimin për të mos u bërë pengesë për muajt në vazhdim, këshilli procedoi në këtë mënyrë: me mendimin se edhe në muajt në vazhdim, mund të kemi mungesa nga anëtarët e këshillit, u propozua që këtë funksion, miratimin e projektvendimit “Për miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike” për muajt korrik e gusht 2012”, t’i “delegohet” Komisionit të Ligjshmërisë!

-Por sa të ligjshëm jemi?- pyeti një nga këshilltarët.

E gjitha kjo ishte dhe mbledhja e radhës, që u zhvillua dhe u mbyll për 10-12 minuta. Rendi i ditës vetëm me një çështje. Nuk kishte si të ndodhte ndryshe, pasi dhe rendi i ditës dhe përgatitja ishte e tillë. Morën pjesë 16 anëtarë nga 25.

Nuk ishte mbledhur Komisioni i Ligjshmërisë dhe i Çështjeve Sociale.

Nuk u kërkua dhe nuk u dha asnjë lloj informacioni. Asnjë pyetje dhe asnjë diskutim. U propozua mendimi i mësipërm, i cili u miratua me 14 vota pro dhe dy kundër.

Por sa ligjor është një veprim i tillë: delegimi i një kompetence një strukture tjetër? Apo shfrytëzimi i mbledhjes së Komisionit në vend të Këshillit, një mbledhje e cila shihet e pamundur. Bashkitë dhe Komunitat në Republikën e Shqipërisë organizohen dhe funksionojnë në bazë të Ligjit Nr. 8652, datë 31.07.2000. Mbi këtë bazë është hartuar dhe miratuar Rregullorja e Brendshme e Këshillit të Bashkisë Pogradec me vendimin nr.64, datë 28.12.2000, së cilës deri më sot nuk i është bërë asnjë amendim.

Funksioni i delegimit as dhe termi “delegim” nuk haset në asnjë nen të saj. Ligji 8652 në Nenin 2, pika 2 sqaron: “Funksione të deleguara” janë funksione të Pushtetit Qendror ose të institucioneve të tjera qendrore, që me ligj ose me marrëveshje caktohen të realizohen nga njësitë e Qeverisjes Vendore në mënyrën dhe masën e përcaktuar nga Pushteti Qendror dhe institucione të tjera qendrore.” Nuk kemi nene

të veçantë që Këshilli Bashkiak apo Komunitar mund të delegojë kompetenca për probleme të ndryshme një strukture të tij, siç janë komisionet e përhershme apo të përkohëshme të tyre. Disa këshilltarë e argumentonin këtë me “parimin”: ajo, që nuk është e ndaluar, është e lejuar dhe anasjelltas. Po ku vepron, ku mund dhe gjer ku e ka fushën e veprimit ky parim?!

Ata marrin shkas për një interpretim të tillë nga “KARAKTERISTIKAT e Komiteteve dhe Komisioneve” sipas legjislacionit në fuqi dhe Të drejtat e njësisve të qeverisjes vendore (ligji 8652 neni 8 pika 1 gërma d) ku për rrjedhojë Këshilli mund të delegojë ushtrimin e të drejtave strukturave të tjera kur lind nevoja e komisioneve të veçanta për nga objekti dhe lënda e trajtimit!

Por, a është ky një argument në lojë dhe a ka bazë ligjore delegimi i një kompetence, që jo vetëm nuk është një çështje komplekse dhe e re, por është nga ato çështje që këshilli e ka të përhershme në rendin e ditës? Mbledhja e radhës e këshillit bashkiak duhet të kalojë në protokollimin e këtij vendimi, ndryshe do të na duhet të raportojmë strukturat gjegjëse për një shkëlqje të rregullores së brendshme të këshillit.

IMPRESIONE NGA PANAIRI “BËJ TË DËGJOHET ZËRI YT!”

Nuk e kisha menduar ndonjëherë se do të më jepej mundësia për të takuar ambasadorin e SHBA-ve, z. Arvizu. Gjithmonë e kam vlerësuar për reformat dhe projektet integruese, të cilat ai ka iniciuar në Shqipëri, por nisma e fundit që ai ndërmoi ishte vërtet për t’u lavdëruar.

Panairi konsistonte në ndërgjegjësimin e gjithë komunitetit shqiptar për luftimin e problemeve sociale si dhuna, gjakmarrja, korrupsioni, etj. Dhe natyrisht, rolin më të rëndësishëm për të bërë këto ndryshime e për të hedhur hapat e mëdhenj të integritetit dhe civilizimit në shoqëri e kanë ndërmarrë këto OJF, të cilat ditën e 21 qershorit, para Galerisë së Arteve, shpalosën më fuqishëm se kurrë platformat e tyre, objektivat dhe aktivitetet që kanë realizuar në kuadër të ndryshimeve rrënjësore sociale në shoqërinë shqiptare.

Ja, aty tek stenda 6, ndodheshim edhe ne, Shoqata “Unë, Gruaja” nga Pogradeci, një grup vullnetarësh të përfaqësuar prej shtatë aktivistësh. Shpalosja e programit tonë dhe aktiviteteve të shumta të Shoqatës “Unë, Gruaja”, përmbushën jo vetëm krenarinë tonë, por edhe shijuan suksesin e të qenit pjesë e një aktiviteti të tillë me pjesëmarrje të OJF-ve nga e gjithë Shqipëria.

Ja sesi nisi udhëtimi ynë... Na u desh të niseshim herët për të

mbërritur në Tiranë në orën 11:00, ora zyrtare e fillimit të aktivitetit. Megjithatë udhëtimi ishte i gjatë dhe vapa po na mundonte pak, askujt prej nesh nuk i bënte përshtypje kjo, pasi atë ditë kushdo nga ne kishte një rol të rëndësishëm. Kishte momentin për të thënë diçka, i ishim bashkëngjitur thirrjes “Vepra Tani” dhe ai aktivitet do bënte të mundur, që zëri ynë të dëgjohej. Gjatë gjithë udhëtimit u hodhen ide krijuese për rregullimin e stendës ku do të qëndronim, sigurisht që pankartat, broshurat apo librat e botuara nga Shoqata “Unë, Gruaja” zinin vendin kryesor tek tavolina e prezantimit në Panairin ‘Bëj të dëgjohet zëri yt!’.

Kur mbërritëm atje, vumë re që secili grup përfaqësues nga OJQ-të e ndryshme kishin filluar përgatitjet për panairin. Pavarësisht

udhëtimit të gjatë, duke shpërfillur temperaturën mbi 40°, askush nga ne nuk pushoi dhe pas një pune intensive, vërtet që stenda jonë spikaste dhe tërhiqte vëmendjen e të gjithë vizitorëve.

Pati interes të jashtëzakonshëm nga shumë individë, për të gjitha materialet e reklamuar, por ato që ngjallën më shumë interes ishin numrat e ndryshëm dhe shumëpërmasorë të gazetës “Nositi”. Për t’u diferencuar ishte buletini i botuar për projektin “Angazhohu – Monitoro – Vepra”, një botim i cili ka rritur ndërgjegjëshmërinë sociale në qytetin tonë të vogël dhe piktoresk, ku natyrisht nevojitet monitorimi i ecurisë së vendimmarrjes lokale, ashtu si në çdo strukturë të pushtetit vendor në vendin tonë tranzitor.

Momenti i vizitës nga ambasadori Arvizu ishte ai më i shumëprituri nga të dyja palët. Grupi ynë, në emër të shoqatës “Unë, Gruaja”, i dhuroi një libër, si akt mirënjohjeje për komentet e tij pozitive dhe motivuese në drejtim të angazhimeve tona. Sigurisht, ky koment u shoqërua nga një foto, e cila do të ruhet me kujdes në arkivën e aktiviteteve të shoqatës sonë. Në përfundim të këtij shkrimi, dua të them që pranë shoqatës “Unë, Gruaja” më janë hapur shumë dyer të ardhmërisë sime, një ftesë e hapur kjo për këdo që do të sendërtojë shkallët e karrierës në një institucion sublim.

Ligerta dhe Leonida KARAJ



“Një karrige, ju lutem!”

DORIAN LEKA

Monitorimi i Këshillit Bashkiak ka një historik të brishtë dhe thatacak në aspektin e pjesëmarrjes, ai ka filluar me mjete, mënyra dhe prani diversive qysh në kohë. (të mos keqkuptohemi, flas për mbikqyrjen nga Shoqëria Civile, jo nga kontrolli i brendshëm institucional dhe organet e emëruara nga pushteti qendror). Fillimisht, vendimet e votuara nga këshilli bashkiak dhe rendi i ditës diskutoheshin në tavolina kafenesh, takime të gjata rastësore mes zhurmave të qytetit nëpër trotuare, deri edhe në shkrime të ndjera nga dikush që i cënoheshin interesat (vetjake apo partiake) dhe nuk e frenonte betejën e brendshme për t’u shprehur në ndonjë gazetë province apo metropoli. Por të gjitha këto, miqtë e mi, realizoheshin nga përmbledhje opinionesh në distancë... kam dëgjuar që e quanin "monitorim". Kompetenca e shqyrtimit dhe mendimdhënies së këtyre të fundit ka qenë joproductive dhe natyrisht, e paqenësishme. Është njësoj si të shkruash për mbresëlënien e një shfaqjeje nga rrefimi emotiv i disa të njohurve të tu, të cilët ishin në llozhë duke shijuar drejtpërdrejt dukjen teatrale, ndërsa ti endeshe disa vite dritë larg dëgjimit dhe shikueshmërisë.

Por kjo gjendje ndryshoi shumë shpejt me disa qytetarë të interesuar dhe të etur për të zhvilluar jo vetëm profesionin e tyre (juristë të rinj, gazetarë, punonjës socialë, përfaqësues së Shoqërisë Civile, "hallexhinj", etj), por edhe për të kalkuluar kartonat dhe procesin e vendimmarrjes, në përmbushje të një detyre qytetare, e cila personifikon qartazi "gurin e qoshes" për ardhmërinë e tyre dhe të qytetit.



Në këtë kohë, përveç punonjësve të administratës dhe atyre subjekteve që prekeshin drejtpërdrejt nga rendi i ditës së një mbledhjeje bashkiake, nuk kishte pretendentë për të shtuar "karriget e monitorimit".... e them me bindje të plotë, pasi kur monitoruesit filluan të frekuentojnë sallën e mbledhjeve të këshillit, u duhej të luteshin: Një karrige ju lutem!

Prania e monitoruesve me moshë të larmishme dhe interesa të gjera, i shtuan diversitetin e komunikueshmërisë dhe përgjegjshmërinë këshillit bashkiak, i cili nisi të zbatonte në mënyrë rigorozë të paktën aspektin procedural të parashikuar në Ligjin për Qeverisjen Vendore dhe Rregulloren e Brendshme. Për të mos folur për debatet e ashpra, notat e të cilave merrnin flakë me vështrime kuptimplota nga objektivi i kamerës së televizionit apo personave monitorues, si për

të kërkuar aprovimin e një kundërshtimi të denjë në drejtim të interesit qytetar (apo krenarisë personale të debatuesit). Shkrime të larmishme reflektuese pushtuan disa gazeta të zëshme dhe komunikimet brenda dhe jashtë me këshilltarët, kryetarin e bashkisë dhe ndonjë deputet të ndërgjegjshëm, sollën në shtimin e karrigeve të monitoruesve, sy dhe veshë të rinj, duke përmendur këtu edhe regjistrimin e përhershëm nga kamerat e televizionit lokal Sot7.

Sot, mjafton të përmendim që në një prej mbledhjeve të monitoruara nga ekipi ynë "ANGAZHOSHU – MONITORO – VEPRO", në shtim e sipër të aktivistëve vullnetarë, unë dhe Ledioni përsëritëm lutjen e para një dekade: -Një karrige ju lutem! Edhe pse mungesa e qytetarëve jashtë grupit tonë ndihet në mënyrë të konsiderueshme, përsëri me ftesë të hapur për monitorim dhe pjesëmarrje, ju pohojmë se salla e re e Këshillit Bashkiak, premtion vende për këdo të interesuar, ndryshe nga e kaluara. Pikërisht kjo më fal kënaqësi dhe më bën të ndihem i shumëpërfaqësuar, jo vetëm nga këshilltarët, kryesia e bashkisë, por tashmë, edhe nga qytetarët e interesuar për procesin thelbësor të vendimmarrjes. Këta vektorë në rritje nxjerrin rezultanten e dëshiruar, që të jemi pranë vendimmarrjes lokale me dëshirën dhe domosdoshmërinë për të njohur, zhvilluar dhe ruajtur me fanatizëm vlerat e qytetit tonë piktoresk, natyrisht në shinat e duhura ligjore.



Grupi Monitorues i Këshillit të Bashkisë Pogradec

1. Dorian Leka
2. Ligerta Karaj
3. Ledjan Zeqollari
4. Mariglen Vreto
5. Leonida Karaj
6. Marsela Çuli
7. Alda Isallari
8. Denada Mani
9. Xhensila Topçiu
10. Alban Gusho
11. Besmira Isallari

A E DINI SE:

Në vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr. 2, datë 02.02.2001, janë bërë ndryshimet e mëposhtme:

Në pikën I, "Për mbrojtjen e mjedisit", neni 7:

A. Mbrojtja e parqeve dhe mjediseve të gjelbëruara.

ISHTE:

Ndalohet mbledhja e farërave, e luleve dhe e gjetheve të drurëve dhe të bimëve të gjelbërimit rrugor pa marrë lejë nga Bashkia.

BËHET:

Ndalohet mbledhja e farërave, e luleve dhe e gjetheve të drurëve dhe të bimëve të gjelbërimit rrugor pa marrë lejë nga Bashkia.



Në pikën I, "Për mbrojtjen e mjedisit", neni 8:

A. Mbrojtja e parqeve dhe mjediseve të gjelbëruara.

ISHTE:

Ndalohet kullotja e bagetive të çdo lloji në sipërfaqet e gjelbëruara të qytetit, në varrezat e dëshmorëve dhe në ato publike.

BËHET:

Ndalohet kullotja e bagetive të çdo lloji në sipërfaqet e gjelbëruara të qytetit, në varrezat e dëshmorëve dhe në ato publike.



Në pikën I, "Për mbrojtjen e mjedisit", neni 9:

B. Mbrojtja e mjedisit rreth zonave të banimit, objekteve social-kulturore, të prodhimit dhe të lokaleve në qytet.

ISHTE:

Ndalohet hedhja e mbeturinave familjare jashtë vendeve të caktuara, nga dritaret dhe nga ballkonet në ambientet publike.

BËHET:

Ndalohet hedhja e mbeturinave familjare jashtë vendeve të caktuara, nga dritaret dhe nga ballkonet në ambientet publike.



Në pikën I, "Për mbrojtjen e mjedisit", neni 10:

C. Mbrojtja e mjedisit rreth zonave të banimit, objekteve social-kulturore, të prodhimit dhe të lokaleve në qytet.

ISHTE:

Ndalohet hedhja e mbeturinave të lokaleve private dhe të institucioneve shtetërore jashtë vendeve të caktuara.

BËHET:

Ndalohet hedhja e mbeturinave të lokaleve private dhe të institucioneve shtetërore jashtë vendeve të caktuara.



Në pikën I, "Për mbrojtjen e mjedisit", neni 11:

B. Mbrojtja e mjedisit rreth zonave të banimit, objekteve social-kulturore, të prodhimit dhe të lokaleve në qytet.

ISHTE:

Ndalohet hedhja e mbeturinave në vendet e caktuara jashtë orarit të përcaktuar prej orës 08.00-18.00 në dimër dhe nga ora 07.00-19.00 në verë.

BËHET:

Ndalohet hedhja e mbeturinave në vendet e caktuara jashtë orarit të përcaktuar prej orës 08.00-18.00 në dimër dhe nga ora 07.00-19.00 në verë.



Në pikën I, "Për mbrojtjen e mjedisit", neni 1:

A. Mbrojtja e parqeve dhe mjediseve të gjelbëruara.

ISHTE:

Ndalohet organizimi i veprimtarisë të ndryshme kulturore dhe artistike, turistike dhe të ushqimit social brenda kufijve të parkut dhe të sipërfaqeve të gjelbëruara të qytetit pa miratimin e Bashkisë.

BËHET:

Ndalohet organizimi i veprimtarisë të ndryshme kulturore dhe artistike, turistike dhe të ushqimit social brenda kufijve të parkut dhe të sipërfaqeve të gjelbëruara të qytetit pa miratimin e Bashkisë.



Në pikën I, "Për mbrojtjen e mjedisit", neni 2:

A. Mbrojtja e parqeve dhe mjediseve të gjelbëruara.

ISHTE:

Ndalohet prerja e druve, shkurreve, si dhe shkulja dhe dëmtimi i sipërfaqeve me bar dekorativ, i luleve, i stolave, i bordurave dhe rrugëve midis tyre.

BËHET:

Ndalohet prerja e druve, shkurreve, si dhe shkulja dhe dëmtimi i sipërfaqeve me bar dekorativ, i luleve, i stolave, i bordurave dhe rrugëve midis tyre.



Në pikën I, "Për mbrojtjen e mjedisit", neni 3:

A. Mbrojtja e parqeve dhe mjediseve të gjelbëruara

ISHTE:

Ndalohet qarkullimi i makinave, karrocave dhe biçikletave në territoret e gjelbëruara.

BËHET:

Ndalohet qarkullimi i makinave, karrocave dhe biçikletave në territoret e gjelbëruara.



Në pikën I, "Për mbrojtjen e mjedisit", neni 5:

A. Mbrojtja e parqeve dhe mjediseve të gjelbëruara.

ISHTE:

Ndalohet ndezja e zjarreve dhe djegia e mbeturinave të ndryshme.

BËHET:

Ndalohet ndezja e zjarreve dhe djegia e mbeturinave të ndryshme.



Në pikën I, "Për mbrojtjen e mjedisit", neni 6:

A. Mbrojtja e parqeve dhe mjediseve të gjelbëruara.

ISHTE:

Ndalohet loja me top brenda territorit të plazhit dhe në mjediset e gjelbëruara. Gjoha 200 lek

BËHET:

Ndalohet loja me top brenda territorit të plazhit dhe në mjediset e gjelbëruara. Gjoha 500 lek



INFORMOHUNI

Në pikën I, "Për mbrojtjen e mjedisit", neni 12:

C. Mbrojtja e mjedisit rreth zonave të banimit, objekteve social-kulturore, të prodhimit dhe të lokaleve në qytet.

ISHTE:
Ndalohet depozitimi i mbetjeve teknologjike, mbetjeve ushqimore dhe produkteve industriale, të punishteve dhe fabrikave për qytetarët.

BËHET:
Ndalohet depozitimi i mbetjeve teknologjike, mbetjeve ushqimore dhe produkteve industriale, të punishteve dhe fabrikave për qytetarët.



Në pikën e 1, "Për mbrojtjen e mjedisit", neni 13:

B. Mbrojtja e mjedisit rreth zonave të banimit, objekteve social-kulturore, të prodhimit dhe të lokaleve në qytet.

ISHTE:
Ndalohet depozitimi i mbetjeve të lokaleve, institucioneve publike dhe private në rrugë dhe para tyre. Lokalet janë të detyruar të mbajnë kosha dhe qese brenda lokalit për t'i hedhur ato në orarin e caktuar.

BËHET:
Ndalohet depozitimi i mbetjeve të lokaleve, institucioneve publike dhe private në rrugë dhe para tyre. Lokalet janë të detyruar të mbajnë kosha dhe qese brenda lokalit për t'i hedhur ato në orarin e caktuar.



Në pikën e 1, "Për mbrojtjen e mjedisit", neni 16:

C. Mbrojtja e mjedisit dhe infrastrukturës nga ndërtimet.

ISHTE:
Ndalohet depozitimi i materialeve për ndërtim, riparim, rikonstruksion e punime të tjera pa rrethuar territorin sipas rregullave të sigurimit teknik.

BËHET:
Ndalohet depozitimi i materialeve për ndërtim, riparim, rikonstruksion dhe punime të tjera pa rrethuar territorin sipas rregullave të sigurimit teknik.



Në pikën I, "Për mbrojtjen e mjedisit", neni 17:

D. Mbrojtja e mjedisit dhe infrastrukturës nga ndërtimet.

ISHTE:
Ndalohet hedhja e mbeturineve të ndërtimeve në vendgrumbullimet e mbetjeve familjare, në shtratin e lumit të qytetit, në bregun e liqenit dhe në vende të tjera të pamiratuara.

BËHET:
Ndalohet hedhja e mbeturineve të ndërtimeve në vendgrumbullimet e mbetjeve familjare, në shtratin e lumit të qytetit, në bregun e liqenit dhe në vende të tjera të pamiratuara.



Në pikën I, "Për mbrojtjen e mjedisit", neni 19:

D. Mbrojtja e mjedisit dhe infrastrukturës nga ndërtimet.

ISHTE:
Në të gjitha rastet kur është dhënë leja e ndërtimit, personat fizikë dhe juridikë detyrohen të kthejnë në gjendjen e mëparshme brenda kushteve teknike rrugët, trotuaret etj, dhe në afatin kohor të percaktuar nga organet përkatëse.

BËHET:
Në të gjitha rastet kur është dhënë leja e ndërtimit, personat fizikë dhe juridikë detyrohen të kthejnë në gjendjen e mëparshme brenda kushteve teknike rrugët, trotuaret etj, dhe në afatin kohor të percaktuar nga organet përkatëse.



Në pikën I, "Për mbrojtjen e mjedisit", neni 20:

D. Mbrojtja e mjedisit dhe infrastrukturës nga ndërtimet.

ISHTE:
Ndalohet ndërhyrja e paautorizuar në rrjetin rrugor dhe atë inxhinierik (kanalizime, ujësjellësa, elektrike, telefonike).

BËHET:
Ndalohet ndërhyrja e paautorizuar në rrjetin rrugor dhe atë inxhinierik (kanalizime, ujësjellësa, elektrike, telefonike).

Nga persona fizikë:



Nga persona juridikë:



Në pikën I, "Për mbrojtjen e mjedisit", neni 21:

C. Mbrojtja e mjedisit dhe infrastrukturës nga ndërtimet.

ISHTE:
Ndalohet zënia dhe rrethimi i mjediseve publike si lulishte, plazhe, trotuare etj.

BËHET:
Ndalohet zënia dhe rrethimi i mjediseve publike si lulishte, plazhe, trotuare etj.



Në pikën I, "Për mbrojtjen e mjedisit", neni 22:

C. Mbrojtja e mjedisit dhe infrastrukturës nga ndërtimet.

ISHTE:
Ndalohet shitja ambulante e karburanteve të ndryshëm.
Gjoha 1000 lek

BËHET:
Ndalohet shitja ambulante e karburanteve të ndryshëm.
Gjoha 2000 lek



Në pikën e II-të, "Për ruajtjen e rregullit dhe qarkullimit rrugor", neni 23:

ISHTE:
Vendqëndrimet e mjeteve të transportit në qytet caktohen nga Këshilli i Bashkisë sipas veprimtarisë përkatëse. Ndalohet qëndrimi jashtë vendeve të caktuara.

BËHET:
Vendqëndrimet e mjeteve të transportit në qytet caktohen nga Këshilli i Bashkisë sipas veprimtarisë përkatëse. Ndalohet qëndrimi jashtë vendeve të caktuara.



Njoftim punësimi

Në kuadër të projektit *"Fuqizimi ekonomik i gruas në zonat turistike nëpërmjet prodhimeve të punës me dorë"*, Shoqata e Grave me Probleme Sociale shpall konkursin për dy mësuese të punës me dorë, përkatësisht një në zonën e Tushemisht/Pogradec dhe një në zonën e Voskopjës/Korcë.

Njohuritë dhe eksperiencia:

- Eksperiencia të mëparshme të prodhimit të punimeve me dorë;
- Eksperiencia të mëparshme në mësimin e aftësive për bërjen e punimeve me dorë;
- Njohje shumë të mira të prodhimeve të punës me dorë dhe të tendencave më të fundit;
- Aftësi shumë të mira në prezantim dhe lehtësim;
- Aftësi shumë të mira komunikimi;
- Aftësi shumë të mira në planifikim dhe menaxhimin e kohës;

Procedura e aplikimit: Personat e interesuar duhet të paraqesin një kopje të CV-së dhe një letër motivimi në adresën: "Inkubatori Artizanal " Shtëpia e Duarve të Arta", Tushemisht, Pogradec, ose në adresën e email: shoqatagrave@yahoo.com deri më datë 25 Gusht 2012.



Shoqata e Grave me Probleme Sociale

Adresa: L.II, Rr " Sefer Efendi ", Tel 052 234600, website: www.drejtisesociale.com
e-mail: shoqatagrave@yahoo.com

Terma Reference

Projekti: "Fuqizimiil Grave në zonat turistike nëpërmejt produkteve të punës me dorë", Programi i BE, IPA/CBC Programme 2007 - 2013

Shoqata e Grave me Probleme Sociale

Pozicioni: Mësues i Punimeve me Dore
Vendodhja: Tushemisht, PogradecVoskopjë, Korcë

Informacion mbi SHGPS

Shoqata e Grave me Probleme Sociale (SHGPS) është një organizatë jo- qeveritare, e krijuar në 1999, me seli qendrore në qytetin e Durrësit. Ajo synon të mbrojë të drejtat e grave si pjesë e të drejtave të njeriut, të rrisë imazhin publik të gruas dhe prezencën e saj në jetën publike dhe politike si dhe të zhvillojë alternative dhe mundësi zhvillimi në lidhje me fuqizimin ekonomik të gruas dhe përmirësimin e statusit të saj në shoqëri.

Qëllimi i Projektit

Projekti synon mbështetjen e Rajonit të Korcës për të zhvilluar një model të mundësive të gjenerimit të të ardhurave për gratë nëpërmjet krijimit të inkubatorëve artizanalë në Tushemisht/Pogradec dhe Voskopojë/Korcë si dhe të ndihmojnë në zhvillimin e një vizioni strategjik për të bërë kulturën rajonale aksesibile tek turistët potencialë.

Eksperiencia dhe aftësitë e kërkuara për mësuesit e punës me dorë:

- ↪ Eksperiencia të mëparshme të prodhimit të punimeve me dorë;
- ↪ Eksperiencia të mëparshme në mësimin e aftësive për bërjen e punimeve me dorë;

Vacancy Announcement

Association for Women with Social Problems (AWSP) is looking for an National Expert to draft Culture Marketing Strategy for Korca Region, in the frame of the implementation of the project "Empowerment of Women in Touristic Areas through Handcrafting Production" financed by European Union in framework of Cross-Border Cooperation Programme Former Yugoslav Republic of Macedonia - Albania, 2007-2013 Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA), Component II, Contract number: 2012/287-583.

The National Expert is expected to start work on 1 September 2012 and will have to work for a total of 35 days within a period of 3 months (September – November 2012). Interested applicants are requested to submit their applications to:

Association for Women with Social Problems (AWSP)

L.2, Rr. Sefer Efendiu, Pall 1355,

Durres, Albania

or via email to: shoqatagrave@yahoo.com

The application should contain: a recent Cv and letter of motivation.

Kindly note that the deadline for submitting your application is 25 August 2012.

- ↪ Njohje shumë të mira të prodhimeve të punës me dorë dhe të tendencave më të fundit;
- ↪ Aftësi shumë të mira në prezantim dhe lehtësim;
- ↪ Aftësi shumë të mira komunikimi;
- ↪ Aftësi shumë të mira në planifikim dhe menaxhimin e kohës;

Përgjegjësitë dhe detyrat e Mësuesit/ve të punës me dorë:

Mësuesi i punës me dorë do të jetë përgjegjës për:

- ↪ trainimin e grave në fushën e punimeve të punës me dorë tradicionale dhe të reja në zonën Tushemisht/Voskopjë.
- ↪ do punojë në drejtim të rritjes së kapaciteteve të grave që do të jenë pjesëmarrëse të inkubatorit artizanal për punën me dorë, duke përfshirë punën më grep, shtiza, suvajakë, tehzgjah etj nëpërmjet sesione të organizuara në bazë javore.
- ↪ do të përgatisë modulet e paketës së trainimit që do të zhvillohet gjatë periudhës kohore trainim
- ↪ do të drejtojë takimet dhe sesionet e mësimit të organizuara në inkubatorin artizanal cdo javë.
- ↪ mësuesi i punës me dorë do të kontribuojë në organizimin e panairëve të punimeve me dorë te pergatitura gjatë ëorkshopeve që do të organizohen gjatë zbatimit të projektit.

Shënim: Mësuesi i punës me dorë do të punojë nën supervizionin direkt të Skuadrës së Menaxhimit të Projektit.

Kohëzgjatja

Puna është e parashikuar të kryhet për një periudhë 14 mujore, 1 Shtator 2012 – 26 Tetor 2013, 60 ditw pune gjithsej, në bazë javore - një herë në javë, 3 orë pune në ditë.

Procedura e Aplikimit

Personat e interesuar duhet të paraqesin një kopje të CV-së dhe një letër motivimi në adresën: "Inkubatori Artizanal " Shtëpia e Duarve të Arta", Tushemisht, Pogradec, ose në adresën e email: shoqatagrave@yahoo.com deri më datë 25 Gusht 2012.

Deklarata për një Qeverisje të Hapur

Ne kemi dijeni se njerëzit në gjithë botën kërkojnë më shumë hapje, transparencë nga qeverisja. Ata po bëjnë thirrje për më shumë pjesëmarrje në punët publike, duke kërkuar mënyra për të bërë qeverisjet e tyre më transparente, të përgjegjshme, reaguese dhe efektive.



Ne pranojmë që vendet janë në faza të ndryshme në përpjekjet e tyre për të promovuar hapjen në qeverisje, dhe që secili prej nesh ndjek një qasje të vazhdueshme me prioritet tona kombëtare dhe rrethanat dhe aspiratat e qytetarëve tanë.

Ne marrim përsipër përgjegjësinë për të kapur këtë moment për forcimin e angazhimeve tona për të promovuar transparencën, luftuar korrupsionin, dhe shfrytëzuar fuqinë e teknologjive për të bërë qeverisjen më efektive dhe më të përgjegjshme.

Ne përkrahim vlerën e hapjes në angazhimin me qytetarët për të përmirësuar shërbimet, menaxhuar burimet publike, promovuar inovacionin dhe krijuar komunitete të sigurt. Ne përqafojmë parimet e transparencës dhe qeverisjes së hapur me një vizion drejt arritjes së prosperitetit, mirëqenies dhe dinjitetit njerëzor në vendet tona dhe në një botë gjithnjë e më shumë të ndërlidhur.

SË BASHKU NE DEKLAROJMË ANGAZHIMET TONA PËR:

Rritje të disponueshmërisë së informacionit për aktivitetet qeveritare.

Qeveritë mbledhin dhe mbajnë të dhëna në interes të njerëzve dhe qytetarët kanë të drejtë të kërkojnë informacion mbi aktivitetin qeveritar. Ne angazhohemi për të promovuar akses të shtuar të informacionit dhe dhënien e informacioneve shpjeguese dhe zbardhjen në çdo nivel të qeverisjes.

Ne angazhohemi për të rritur përpjekjet për mbledhjen dhe sistemin sistematik të të dhënave mbi shpenzime qeveritare, dhe performancës për shërbime dhe aktivitete publike thelbësore.

Ne angazhohemi për të bërë proaktive dhe për të siguruar informacion me vlerë të madhe përfshi row data (të dhëna të papërpunuara) në kohën e duhur në formate që publiku të mundet lehtësisht të lokalizojë, kuptojë dhe të përdorë, e njëkohësisht të jenë lehtësisht të ripërdorshme. Ne angazhohemi që të sigurojmë akses për mjete efektive kur informacioni përkatës është mbajtur në mënyrë të papërshtatshme, duke përfshirë mjetet juridike efektive të procesit të

rekursit. Ne njohim rëndësinë e standardeve të hapura për të promovuar akses të shoqërisë civile për të dhëna publike. Si dhe për lehtësimin e ndërveprimit të sistemit të informacionit qeveritar. Ne angazhohemi për të

kërkuar reagim (feedback) nga publiku për të identifikuar informacionin me vlerë të madhe për ta, dhe premtojmë të marrim reagime dhe ti konsiderojmë maksimalisht.

Mbështetje për pjesëmarrjen qytetare.

Ne vlerësojmë pjesëmarrjen publike të gjithë njerëzve, në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim, në vendimmarrjen dhe hartim politikash. Angazhimi publik duke përfshirë pjesëmarrjen e plotë të grave rrit efektivitetin e qeverive, te cilat përfitojnë nga njohuritë e njerëzve, ide dhe aftësi për të siguruar mbikëqyrje. Ne angazhohemi për të bërë formulimin e politikave dhe vendimmarrjes më transparente duke krijuar dhe përdorur mjete për ta kërkuar reagimin publik, dhe thellimin e pjesëmarrjes publike në zhvillimin, monitorimin dhe vlerësimin e aktivitetit qeveritar. Ne angazhohemi të mbrojmë aftësinë e organizmave jofitimprurëse dhe shoqërisë civile për të vepruar në mënyrë konsistente me angazhimin tonë për lirinë e shprehjes, angazhimin dhe opinionin. Ne angazhohemi të krijojmë mekanizma për mundësim të bashkëpunimit maksimal të qeverive me shoqërinë civile dhe biznesin.

Zbatimit të standardeve më të larta të integritetit profesional në mbarë administratën tonë.

Qeverisja e përgjegjshme kërkon standarde të larta etike dhe kode sjelle që drejtojnë zyrtarët publike. Ne angazhohemi për të pasur politika të fuqishme antikorrupsioni, mekanizma dhe praktika për të siguruar transparencë në menaxhimin e financave publike, blerjeve qeveritare, forcimin e sundimit të ligjit. Ne angazhohemi për ruajtjen ose krijimin e një kuadri ligjor për të bërë publike informacione mbi të ardhurat dhe asetet e zyrtarëve të lartë publik. Ne angazhohemi për miratim dhe zbatimin e ligjeve që mbrojnë informuesit. Ne angazhohemi për të realizuar informimin rreth aktivitetit dhe masave tona antikorrupsion dhe organet e zbatimit të informimit. Ne angazhohemi për të rritur frikën nga mitmarrja dhe forma të tjera të korrupsionit në sektorin publik dhe privat, po kështu në shkëmbimin e informacionit dhe ekspertizës.

Rritje e qasjes në teknologjitë e reja për hapje dhe llogaridhënie.

Teknologjitë e reja ofrojnë mundësi për shkëmbim, pjesëmarrje publike dhe bashkëpunim. Ne synojmë të shfrytëzohet këto teknologji për të bërë publike sa më shumë informacion në mënyrë që njerëzit të kuptojnë çfarë bëjnë qeveritë e tyre dhe të influencojnë në vendimmarrje. Ne angazhohemi të zhvillojmë aksesin dhe sigurojmë hapësira online si platforma për delegimin e shërbimeve, tërheqje publiku dhe shpërndarje informacioni dhe idesh. Ne pranojmë se aksesin e barabartë dhe i pranueshëm tek teknologjia është një sfidë, dhe angazhon për të kërkuar rritje të internetit dhe lidhjeve mobil, ndërsa gjithashtu identifikon dhe promovon përdorimin e mekanizmave alternativ për angazhimin civil. Ne marrim përsipër të angazhohet shoqërinë civile dhe komunitetin e biznesit të identifikojnë praktika efektive dhe qasje inovative për të lëvruar teknologji të reja për të fuqizuar njerëzit dhe promovuar transparencën në qeverisje. Ne gjithashtu pranojmë se rritja e aksesit tek teknologjia përfshin mbështetjen për aftësimin e qytetarëve dhe qeverisë për ta përdorur atë. Ne angazhohemi të mbështesim dhe zhvillojmë përdorimin e inovacionit teknologjik nga nëpunës qeveritarë dhe qytetarë të thjeshtë. Ne gjithashtu kuptojmë se teknologjia ka rol plotësues dhe jo zëvendësues për informacion të qartë, të përdorshëm dhe të dobishëm.

Ne pranojmë se qeverisja e hapur është një proces që kërkon një angazhim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm. Në angazhohemi të reklamojmë mbi veprimet e ndërmarra për të realizuar principet, për t'u konsultuar me publikun në përfshirjen e tij, dhe ripërtëritjen e angazhimeve tona në dritën e sfidave dhe mundësive të reja.

Ne premtojmë të drejtohem nga shembuj dhe kontribute për të avancuar qeverisje të hapura në vende të tjera duke ndarë praktikat më të mira dhe ekspertizën si dhe duke ndërmarrë angazhimet e shprehura në këtë deklaratë mbi baza vullnetare jo të detyrueshme. Ne angazhohemi të përkrahim këto principe në angazhimin tonë ndërkombëtar, dhe të punojmë për të nxitur një kulturë globale për qeverisje të hapura që fuqizojnë dhe japin për qytetarët, dhe avancojnë idealet për hapje dhe pjesëmarrje të qeverive të shekullit të XXI-të.



QUIZ

Ky pyetësor synon të testojë informimin e qytetarëve për kompetencat, funksionet dhe rolin e Kryetarit të Bashkisë ose Komunës

Zgjidh alternativën e duhur, PO ose JO duke shënuar kuadratin

(Shkëputur nga Ligji Nr.8652, datë 31.7.2000 ‘PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QEVERISJES VENDORE’)

Neni 39

Kryetari i komunës ose bashkisë

Çdo komunë ose bashki ka kryetarin e saj të zgjedhur çdo tre vjet në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë, sipas mënyrës së parashikuar në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

PO JO

Kryetari i komunës ose bashkisë, në kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tij, ndihmohet nga një ose më shumë zëvendëskryetarë. Numri i zëvendëskryetarëve caktohet nga këshilli komunal ose bashkiak. Emërimi dhe shkarkimi i tyre bëhet nga kryetari i qarkut.

PO JO

Neni 40

Mandati i kryetarit të komunës ose bashkisë

Mandati i kryetarit të komunës ose bashkisë vërtetohet nga gjykata në juridiksionin e së cilës përfshihet komuna ose bashkia përkatëse, brenda 100 ditëve nga data e shpalljes së rezultatit të zgjedhjes së tij.

PO JO

Deklarimi i pavlefshmërisë së mandatit të kryetarit bëhet kur vërehet se nuk plotësohen kushtet sipas nenit 45 të Kushtetutës dhe nenit 10 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

PO JO

Shpallja e vlefshmërisë së mandatit të kryetarit të komunës ose bashkisë bëhet në mbledhjen më të parë të këshillit komunal ose bashkiak përkatës, ku kryetari bën betimin sipas formulës së përcaktuar në nenin 28 të këtij ligji dhe e nënshkruan atë.

PO JO

Ushtrimi i mandatit të kryetarit të komunës ose bashkisë fillon në çastin kur hap mbledhjen

e parë të këshillit bashkiak dhe përfundon kur deklaron të mbyllur mbledhjen e fundit.

PO JO

Në rast se këshilli bashkiak ose komunal nuk mblidhet brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, deputeti i zonës organizon ceremoninë e betimit të kryetarit të bashkisë ose komunës në mjedisin e bashkisë ose komunës dhe në praninë e banorëve të njësisë përkatëse.

Neni 41

Përfundimi para kohe i mandatit të kryetarit të komunës ose bashkisë

Mandati i kryetarit të komunës ose bashkisë përfundon përpara afatit në rastet kur kryetari:

a) pranon të bëjë betimin;

PO JO

b) nuk jep dorëheqjen;

PO JO

c) nuk është më banor i përhershëm i komunës ose bashkisë, ku është zgjedhur;

PO JO

ç) shkarkohet nga organi kompetent, sipas nenit 42 të këtij ligji;

PO JO

d) kandidon ose zgjidhet deputet;

PO JO

dh) humbet zotësinë juridike për të vepruar me deklaratë të bërë publike në media;

e) vdes.

PO JO

Kryetari i komunës ose bashkisë në rastet e dorëheqjes e depoziton atë pranë këshillit

komunal ose bashkiak përkatës. Sekretari i këshillit, për ndjekjen e procedurave të nevojshme, njofton deputetin e zonës për dorëheqjen e kryetarit.

PO JO

Për rastet e përfundimit të mandatit të kryetarit përpara afatit, këshilli komunal ose bashkiak, njofton Këshillin e Ministrave nëpërmjet prefektit.

PO JO

Në rastet e përfundimit të parakohshëm të mandatit, organizohen strukturat zgjedhore përkatëse për zëvendësimin e parakohshëm të tij nga kryetari i këshillit bashkiak ose komunal, deri në organizimin e zgjedhjeve për kryetarin e komunës ose bashkisë në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

PO JO

Neni 42

Shkarkimi i kryetarit të komunës ose bashkisë

Kryetari i komunës ose bashkisë shkarkohet me vendim të Këshillit të Komunal ose Bashkiak në rastet kur:

a) kryen shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve;

PO JO

b) dënohet për kryerjen e një vepre penale me vendim të formës së prerë nga gjykata;

PO JO

c) propozohet për shkarkim nga këshilli komunal ose bashkiak përkatës për mosparaqitje në detyrë për një periudhë 3-mujore të pandërprerë.

PO JO

(Vijon në edicionin nr. 6)

SHPERBLIMI

Personat që paraqitën pyetësorin e plotësuar në mënyrë korrekte janë Ida Lalaj dhe Albina Pajo, që shpërblehen përkatësisht me një libër “Komo” dhe një revistë “Poeteka” nga grupi ynë i monitorimit.

Dorëzimi i pyetësorit bëhet tek zyra e shoqatës “Unë, Gruaja”. tel: 083222140

“Publikimi i këtij materiali mbështetet financiarisht nga Zyra e Çështjeve Publike e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë. Mendimet dhe opinionet e shprehura nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Departamentit Amerikan të Shtetit”